



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 05/ 3892 /2026

Drejtoria Komunale për Arsim, në Komunën e Hanit të Elezit sipas UA. Nr:02/2016 të datës 12.01.2016 Neni 11 pika 1, 2, 2.5, 2.12.2, 2.13.3, 2.21 (Për Aktivitete Jashtëshkollore) Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë:

OFERTË

Ofertë për ekskursionin për Maturantët e SHML “Dardania“ Hani i Elezit me afat 3 ditor në Durrës (Shqipëri).

Numri i nxënësve që do të udhëtojnë në Shqipëri është prej **70 deri 80 nxënës**, përfshirë, stafin e shkollës, mjekun kujdestar dhe drejtorin e shkollës.

Ekskursioni ka karakter edukativo-arsimor ku gjatë këtyre 3 ditëve do të vizitohen monumente kulturore-historike.

Itinerari dhe agjenda merret në Drejtorinë për Arsim, në Hani i Elezit. (Komuna Hani i Elezit, kati: përdhese, nr i zyrës 04.

Agjensioni i cili konkuron duhet ti plotësojnë kushtet si më poshtë:

1. Agjensioni duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Infrastrukturës.
2. Licenca e kompanisë nga Ministria e Infrastrukturës për Transport ndërshtetërorë
3. Certifikata e biznesit dhe numri fiskal i kompanisë.
4. Të ketë dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit përfshirë edhe dokumentacionin e kontrollit teknik sipas dispozitave ligjore për 6 mujorin e fundit.
5. Autobusët të jenë me klimë dhe komfor, të kenë kapacitet të mjaftueshëm dhe sipas standardeve për transportin e nxënësve.
6. Agjensioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve (të dëshmohet me certifikatë mjekësore).
7. Agjensionet duhen të kenë tri (3) referenca pozitive për transportin për tre (3) vitet e fundit.
8. Agjensioni duhet të siguroj përkujdesën mjekësor të nxënësve (dëshmi: diploma e mjekut dhe certifikata e punës), dhe i njëjti do ti shoqëroj nxënësit.
9. Aplikimi duhet të bëhet në emër të kompanisë – pronari ose punëtori i saj me dëshmi të punës nga Lista e pagave të ATK-së (jo autorizime të ndryshme për personat fizik).
10. Kërkohet një deklaratë me shkrim që të ketë kapacitet hoteli për banim dhe ushqim në një objekt.

Agjenda e vizitës për ekskursionin 3 ditor merret në Drejtori të Komunës

- Data e nisjes është më **13.05.2026**, kthimi është **15.05.2026**.
- Afati i konkurrimit për agjensionet është prej 29.04.2026 deri 04.05.2026 deri ora (14:00) nga dita e shpalljes.
- Oferta dorëzohet në zyrën e drejtorisë së arsimit, komuna Hani i Elezit me emrin e shkollës.
- Hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet me datën: **05.05.2026**, në Komunën e Hanit të Elezit.

Data 29.04.2026

Drejtoria e Arsimit
Hisni Luri

